



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 02
Ndërtesa e Kuvendit, salla S - I
Prishtinë, më 18 tetor 2017, në orën 10:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Faton Topalli.

Të ftuar: Uran Ismaili, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Donika Bajrami, këshilltare MSH, Nijazi Gashi, këshilltar MSH, Rinë Limani, këshilltare MSH, Ervin Ibrahim – UNKT, Agnesa Haxhiu, KDI, Besim Kodra, PRAK dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

REND I DITËS

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 10.10.2017;**
- 3. Takimi njoftues me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Uran Ismaili.**
Diskutim lidhur me prioritetet dhe sfidat e ministrisë;
- 4. Shqyrtimi i draft- planit të punës së komisionit për vitin 2017;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 10.10.2017

Kryetari konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale miratoi, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 10.10.2017.

3. Takimi njoftues me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Uran Ismaili.

Diskutim lidhur me prioritetet dhe sfidat e ministrisë

Kryetarja: Ministër, me lejoni fillimisht të ju urojmë suksese në punë si ministër i Shëndetësisë! Kemi kënaqësinë që në mesin tonë, për herë të parë të kemi ministrin e Shëndetësisë, z. Uran Ismaili. Ju faleminderit z. ministër për prezencën tuaj!

Komisioni, në mbledhjen e kaluar, ka vendosur që t'ju ftojë në takim njoftues. Pra, t'ju dëgjojmë fillimisht juve për sfidat dhe prioritet që i keni ju, si ministri, për këtë vit. Komisioni ynë përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha partive politike që janë në Kuvend. Ne, si Komision, jemi zotuar se do të bashkëpunojmë ngushtë me ju dhe do të jemi mbështetës i juaji nëse ju punoni angazhoheni të avanconi shëndetësinë në të kundërtën nëse nuk punoni ashtu siç duhet të punohet. Ne do të jemi kritikuesit e punës tuaj dhe qeverisë në rolin që kemi si komision.

Atëherë ministër kërkojmë nga ju që të na prezantoni se cilat janë prioritetet dhe sfidat si Ministri e Shëndetësisë. Urdhëroni z. ministër!

Uran Ismaili: Më lejoni t'ju falënderoj ju, kryetare, dhe gjithë anëtarët tjerë të Komisionit. Po ashtu, iu falënderoj edhe për ftesën dhe jam përgjigjur me kënaqësi, do të mundohem që para jush të prezantoj sfidat me të cilat përballemi ne, si ministri, gjithashtu edhe prioritet që i kam, si ministër i ri. Edhe ne zotohemi se do të ju ofrojmë një bashkëpunim të thellë edhe të vazhdueshëm me komisionin për arsye se sektori i shëndetësisë është një sektor i cili na përket gjithë neve dhe sektor i cili nuk është në gjendjen e duhur. Fillimisht po mundohem t'ju prezantoj se si e kam gjetur gjendjen në ministri. Ministria është në një gjendje jo të mirë, kemi shumë ushtrues detyre, duke u nisur që nga sekretari permanente e duke vazhduar të tjerët drejtorë departamenti etj. Duke krijuar një jo stabilitet funksional për ministrin, pra ministria ka një rol rregullator dhe duhet të jetë stabile fillimisht me organizimin e saj, duhet t'i këtë përshkrimin e detyrave për secilin pozicion në mënyrë që përgjegjësin dhe llogaridhënien fillimisht të rrisim brenda institucionit. Unë konsideroj se Ministria e Shëndetësisë, si niveli me i lartë në sektorin e shëndetësisë, duhet t'i vendose rregullat se pari për vetveten të jetë transparente e llogaridhënëse, mandej të kërkojë nga të tjerët të jenë përgjegjës dhe transparent. Një mungesë e stabilitetit funksional krijohet edhe mungesa e llogaridhënies dhe mungesa e zinxhirit institucional. Pra, që nga sekretari dhe shumë drejtorë departamenteve janë ud- detyre dhe një nga prioritetet e mia ka qenë që të fillojmë si ta stabilizojmë këtë institucion. T'i plotësojmë vendet me njerëz të duhur në mënyrë që ata njerëz t'i marrin përgjegjësit e tyre. Si pengese e dytë. Sektori është i nën financiar, pra sektori sot merr 2.6 % të GDP, kurse vendet e rajonit fillon mbi 4 %, ne realisht kemi mungesë të madhe financiare për shërbimet që i ofrojmë. Pra, ne na duhet që të krijojmë një stabilitet financiar për shërbimet që i ofrojmë. Buxheti nuk i shëron të gjitha plagët sepse buxheti ka nevojë për një menaxhim të duhur. Ne sot kemi mungesë

të barnave nëpër institucione shëndetësore dhe mungesa e barnave krijohet edhe për shkak të mungesës së buxhetit dhe menaxhimit jo të duhur. Si pikë e tretë e hallkës institucionale, siç jeni në dijeni kemi pasur një mungesë të funksionimit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar-SHSKUK-së me ushtrues detyre, i cili nuk ka qenë funksional. Një nga punët e para ka qenë që të funksionalizojmë bordin e SHSKUK-së. Bordi është funksional, janë emëruar anëtarët e rinj pas krijimit të Bordit kemi pasur një dorëheqje të drejtorit të SHSKUK-së të z. Curr Gjocaj. Në këtë rast Bordi i SHSKUK-së ka vepruar menjëherë edhe e ka caktuar një ud- drejtor të SHSKUK-së z. Basri Sejdiu. Pra, edhe këtu e kemi plotësuar atë hallkën institucionale që ka munguar. Një sfidë shumë e madhe do të jetë menaxhimi i SHSKUK-së e cila është një organizatë shumë e madhe, e cila është krijuar me qëllim të një reforme e cila njëra është politikë bërës e tjetra ekzekutuese e politikave, mirëpo mungojnë kapacitetet menaxheriale brenda SHSKUK-së dhe kanë nevojë për mbështetje. Ne jemi duke diskutuar me Bankën Botërore që t' i mbështesim me kapacitete menaxheriale SHSKUK. Dhe në këtë rast ne do të kërkojmë nga SHSKUK që të ofrojë shërbime kualitative.

Pra, hallka institucionale stabile funksionale, financimi, menaxhimi me i mirë dhe afrimi i shërbimeve kualitative dhe në kohë do të jenë prioritetet e mia, të cilat besoj se do të arrijë me i realizuar gjatë mandatit tim. Po ashtu jemi duke punuar edhe në sistemin e referimit të pacientëve nga niveli në nivelin tjetër. Një menaxhim me i mirë edhe më stafin shëndetësor, pra të kemi një decentralizim, defuzion të QKUK-së dhe plotësimin e nevojave me staf edhe spitalet e tjera, pra kuadrat të shpërndahen aty ku ka nevojë. Pra, të nisemi me një moto “Që personeli shëndetësor të jetë afër qytetarit, e jo qytetari të vrapojë pas personelit shëndetësor”. Ka shumë spitale të cilat i kam vizituar dhe kanë thënë se kanë shumë shërbime të cilat mund të ofrohen po nuk kemi kapacitete njerëzore për të cilat do të shikojmë mundësinë për një menaxhim më të mirë dhe shpërndarje të tyre. Kjo është sa për fillim, jemi në dispozicionin tuaj që t' ju përgjigjemi pyetjeve dhe vërejtjeve tuaja, nëse keni. Ju faleminderit!

Besa Baftiu: Faleminderit ministër! Ju i përmendet gjitha këto, mirëpo një hallkë shumë e rëndësishme për t' i arritur objektivat tuaja është Sistemi i Informimit Shëndetësor –SISH. Ne programin tuaj qeverisës keni përmendur se do të keni nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare - QMF, mjek apo specialist në këtë rast ligji për Shëndetësi nuk e lejon, pra vetëm ata mjekë që janë aktualisht deri sa të pensionohen. Ne e kemi monitoruar ligjin për shëndetësi dhe kemi vërejtur mangësitë për këtë çështje dhe po besojmë se në të ardhmen duhet të ndryshohet ligji për shëndetësi e nga shumë çështje do të rregullohet edhe kjo, siç e potencuat ju për një menaxhim më të mirë të stafit shëndetësor. Ministër fillimisht po i marrim pyetjet edhe vërejtjet e deputetëve, mandej përgjigjesh. Urdhëroni Naser, pasi që kërkoj leje se ka një takim, le të filloj i pari.

Naser Rugova: Urime ministër, ju urojmë punë të mbarë! Ne dëgjuam me vëmendje ekspozenë tuaj në raport me gjendjen e ministrisë në aspektin e menaxhimit apo zinxhirit institucional. Jeni ministër i një ministrie më të dhimbshme për qytetarët e Kosovës, që 18 vite s' kemi qenë në gjendje të ndërtojmë një sistem stabil për përkujdesjen e shëndetit të qytetarëve tanë. Ne, si komision, do ju mbështesim pa marrë parasysh se a jemi deputetë të pozitës apo opozitës për punët dhe iniciativat e mira, po ashtu do të përballeni fuqishëm me ne për të gjitha mos veprimet apo neglizhencat në përmirësimin e situatës në sistemin shëndetësor. Pasi që jeni në fillim të mandatit do t' ju jap disa sugjerime. Fondi i sigurimeve shëndetësore – FSSH ka qenë premtim publik i qeverisë së kaluar, duhet me urgjencë ta ngritin zërin në qeveri. Ne publikisht kemi kërkuar që qeveria e Kosovës të këtë top prioritet shëndetësinë dhe në fillim të ndajë buxhet në vlerë prej 100 milionë euro. Sistemi Informativ Shëndetësor-SISH duhet të funksionalizohet nuk mund të zhvillojmë sistemin shëndetësor pa një SISH funksional. Duhet të fuqizohet inspektorati

shëndetësor, i cili ka një rol kyç në mbikëqyrjen e institucioneve shëndetësore. Agjencinë Kosovare të Produkteve Medicinale –AKPM, kontrolli i cilësisë së barnave. Jemi shteti me i pa mbrojtur në Evropë, në këtë aspekt nuk kemi origjinë dhe gjenezë se nga na vijnë barnat. Trajtimi jashtë vendit, brenda vitit për trajtim jashtë vendit dhe me kërkim të shërbimeve më të mira qytetarët e Kosovës i shpenzojnë diku mbi 120 deri 150 milionë euro. Cito statiket dhe materialet shpenzuese si mundet një profesionist shëndetësor të kryejë shërbimin në mungesë e pajisjeve elementare. Po ashtu edhe çështja e menaxhimit të kuadrove profesionale duhet të reagohej jo të kemi një ngarkesë në QKUK, kurse spitalet rajonale edhe Qendrat e Mjekësisë Kryesore Familjare-QKMF të kenë mungesë të tyre. Uroj që të kemi bashkëpunim dhe bashkërisht të marrim hapa konkret edhe të përmirësojmë sistemin shëndetësor në vend.

Flora Brovina: Ministër të urojmë sukses në punë, keni pranuar një detyrë shumë të rëndë. Komisioni do të ju monitoroj për punën që po bëni njëherit do të jetë edhe mbështetësi kryesor i punëve të mira, i projekteve dhe i nismave të mira. Ne kemi monitoruar ligjin për shëndetësi si komision, mirëpo fatkeqësisht s’kemi mundur të përfundojmë më miratim të raportit për shkak se ka përfunduar legjislatura para kohe. Ne kemi vërejtur se ky ligj ka shumë zbrazëtira. Pyetje? A mendoni se ky ligj duhet të ndryshohet? Kurse ligji për Shërbimin Mjekësor Emergjent për të cilin ne, si komision, mburremi se kemi bërë një punë shumë të mirë në amendamentimin e tij. Është ligj i cili bënë reformë në shërbimin mjekësor emergjent. Pra, a do të filloni të zbatoni fillimisht të mbështetni me buxhet? Pasi që kërkon buxhet për zbatimin e tij i cili parashihet të fillojë në vitin 2018. Ne pajtohemi me ju se mungesa e buxhetit apo është e nën financuar sistemi shëndetësor, ne, si komision, në vazhdimësi kemi kërkuar që të kemi një buxhet që mbulon nevojat për shërbime shëndetësore cilësore. Ne, gjatë monitorimit, kemi parë probleme që kanë rrjedhur për shkak të centralizimit të menaxhimit të buxhetit nga SHSKUK në raport me Spitalet Rajonale, pra niveli sekondar. Problem tjetër është Shërbimi i Mjekësisë Familjare, ligji për mjekësinë familjare e rregullon ndryshe nga ajo që afrohet, pra qytetarët nuk e dinë se kush është mjeku i tyre. Pyetje. Kur do të procedohet ndryshimi, plotësimi i ligjit për Shëndetësi, mandej të procedohen ligjet e tjera të ndryshohen siç u përmendën nga kolegët këtu si ai i sigurimeve shëndetësore. Po ashtu problem tjetër është edhe mos funksionalizimi i odave të profesionisteve shëndetësore të cilat u themeluan me një bujë shumë të madhe. Odat parashihen të bartin një numër të madh të përgjegjësive të cilat akoma si kanë marrë. Problemi i specializimeve dhe specializanteve është problem në vete ne kemi me shumë specializantë se sa mundësitë që t’i sistemojmë nëpër vendet e tyre të punës, e në realitet kemi mungesë nëpër institucione shëndetësore për specialist. Po ashtu kemi mungesë të stafit të mesëm shëndetësor nëpër institucionet shëndetësore e realiteti është se ne për çdo ditë eksportojmë për vende të huaja staf si profesional dhe staf të mesëm shëndetësor. Ju faleminderit!

Fatmire Kollçaku-Mulhaxha: Urime ministër, ju urojmë punë të mbarë! Unë jam punëtore që punoj në sektorin e preventives në Institutin Kombëtarë të Shëndetit Publik –IKSHP dhe më erdhi mirë që theksuat se do të fokusoheni edhe në preventivë, sepse ministrat kur i vizitojnë spitalet rajonale edhe nivelin parësor asnjëherë nuk i vizitojnë institutet rajonale të cilat janë shumë të rëndësishëm. Unë jam e bindur se deri me tani shumë pak është investuar në preventivë. Ne aktualisht kemi një situatë të re me epidemiologji, pra me fruthin, mirëpo më gjithat shërbimi i vaksinimit deri me tani ka qenë njëra nga hallkat më të ndritshme. Jo vetëm që kërkojmë investim më të madh në preventivë, por konkretisht në shërbim të vaksinimit një mbështetje më të madhe edhe nëpër raportet dhe klinikën infektive, pasi që krahas shërbimit emergjent këto reparte dhe klinika infektive janë vija e parë mbrojtëse për qytetarët. Çështje tjetër problematike është menaxhmenti, ne kemi ligje të mira por nuk zbatohen. Hallka me e dobët në sistemin shëndetësor është menaxhmenti. Shumë pak kemi pasur monitorim të punës së

menaxherëve të institucioneve shëndetësore. Ne kemi shumë pacientë që kërkojnë shërbim jashtë vendit në mungesë të afrimit të disa shërbimeve shëndetësore. Andaj ne duhet të punojmë që t'i afrojmë këto shërbime edhe shërbime funksionale, pasi që kemi staf shumë profesional, mirëpo në mungesë të aparaturave, materialit harxhues disa shërbime nuk funksionojnë. Sa i përket stafit shëndetësor, edukimi i vazhdueshëm profesional është shumë i rëndësishme, mirëpo nuk kemi një monitorim se si po shpenzohet buxheti për edukimin e vazhdueshëm profesional dhe kërkojmë nga ju që të shikoni për çdo vit se kush janë përfitues të këtyre fondeve që mos të përfitojnë njerëz të njëjtë çdo herë dhe t'ju jepet mundësia me e madhe mjekëve që vijnë nga rajonet. Çështja e pagesave për stafin shëndetësor është problematike. Një mjek kardiokirurg paguhet sikur një mjek familjar që punon në një punkt në mjekësinë familjare pa asnjë kriter, pa vlerësim të performancës së punës. Pra, mungojnë kriteret për vlerësimin e performancës së punëtorëve shëndetësorë. Bashkëpunimi me Shqipërinë është i domosdoshëm, pra të ndërtojmë qendra referente si ajo e onkologjisë dhe kardiokirurgjisë. Ju faleminderit!

Haxhi Avdyli: Urime ministër, ju urojmë suksese në detyrën e re, punë të mbarë! Detyrë e Ministrisë është që të hartojë politika e strategji për përmirësimin e shërbimeve në sistemin shëndetësor. Ne nuk pajtohemi e më atë që potencuat se financimi apo rritja nuk është me rëndësi. Është e vërtete se financimi nuk është e vetmja hallkë, po është njëra nga hallkat kryesore që ndikon në përmirësimin e sistemit shëndetësor. Kërkojmë që të rritet financimi në shëndetësi pasi që është nën nivelin rajonal, pra diku 140 € për kokë banori, kurse vendet e rajonit nga 600 € deri 1000 € për kokë banori. Pyetje. A keni kërkuar ju si ministër i Shëndetësisë që fondi apo buxheti prej 17 milionë euro i dedikuar për shëndetësi të ndalet, pra duke ditur se nevojat në sistemin shëndetësor janë shumë të mëdha? A keni kërkuar nga Ministria e Financave apo nga Qeveria që ky buxhet të ri destinohet në programe të tjera për shëndetësi, e kurse për veteranet e UÇK-së të gjinden fondi të tjera? Ne konsiderojmë se Veteranet kanë të drejtë të paguhet, por jo të merren mjetet nga buxheti i MSH-së. Mjetet prej 17 milionë € kanë pasur mundësi ku të ridestinohen si nga blerja apo funksionalizimi i aparaturave diagnostike, furnizimi me barna eliminimi i listave të gjata të pritjes në këtë rast edhe ruajtja e buxhetit familjar të qytetarëve, të cilët po shpenzojnë mjete të konsiderueshme duke kërkuar trajtim nëpër klinika private. Çfarë plani keni për funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore? A mendoni se reforma në shëndetësi mund të behët pa financim apo reforme financiare? Sa i përket reformave në institucionet shëndetësore. A keni plan që të bëni reforma të SHSKUK-së? Ku kemi një status të SHSKUK inkompatibil me sistemin shëndetësor, ku në vend që të kërkojmë decentralizim, përkundrazi kemi centralizuar këtë institucion ku të gjitha spitalet rajonale i kemi futur nën ombrellën e SHSKUK-së. Pra drejtori i SHSKUK-së në vend që të merret me problemet e SHSKUK-së merret edhe më problemet e gjitha spitaleve, që është e pa mundur. A keni plane që të bëni decentralizimin e kompetencave apo reforme të sistemit shëndetësor që ky sistem të jetë sa me integruar. Pra, detyrë imediate është që të merreni me reformimin e sistemit shëndetësor të përgatisni strategji afate gjatë se ku do të jetë sistemi shëndetësor mbas katër viteve, cilat do të jenë ndryshimet në këtë rast do të keni edhe mbështetjen tonë si komision.

Time Kadrijaj: Urime ministër, ju urojmë suksese në detyrën e re! Ne e kuptojmë se në çfarë gjendje gjendet sektori i shëndetësisë, mirëpo ato që u thanë nga kolegët edhe nga ne është mirë që t'i merrni si sugjerimet edhe të filloni me punë të mira në përmirësim të gjendjes së sektorit të shëndetësisë. Ne e dimë se shëndetësisë, përveç që është e nën financiar, po ashtu edhe është keq menaxhuar apo keq qeverisur. Vërtet ka nevojë që të këtë reformë sistemi shëndetësor që të kemi një shëndetësi të mirëfillta për qytetarët, pra të marrin shërbime shëndetësore cilësore. Çështja e specialisteve është një problematike që duhet trajtuar me qëllim që të sistemohen nëpër

institucione tona, e jo të migrojnë nëpër vendet e Evropës. Problemi me furnizim me barna nga lista esenciale. Në këtë rast duhet të krijohet një praktike që furnizimi me barna nga lista esenciale të jetë i rregullt. Çështja e specializimeve duhet të decentralizohet, spitalet rajonale të vendosin në bazë të nevojave edhe kërkesave tyre të përcaktojnë për specializime dhe të lidhet kontrate me atë specializante që për një afat kohor janë të obliguar që të shërbejnë në atë institucion ku e kanë marrë specializimin, e jo të punësohen në QKUK. Inspektorati shëndetësor duhet të fuqizohet është i anashkaluar, po ashtu është institucioni i vetëm që e mbikëqyrë institucionet shëndetësore. Ne ju urojmë suksese në punë dhe besoj se do të kemi një bashkëpunim të ngushtë.

Fikrim Damka: Faleminderit kryetare, ministër të urojmë punë të mbarë në detyrën e re! Në bazë të gjendjes që prezantuat po shihet se keni trashëguar shumë probleme në shëndetësi. Ligji për sigurimet shëndetësore para katër viteve është aprovuar dhe s' kemi akoma një pasqyrë të qartë se deri ku kanë shkuar punët. Të paktën deri me tanë është dashur që të funksionalizohet fondi apo të punësohen punëtorët. Problemi me buxhetin për furnizim me barna, buxhet i cili para dy viteve ka qenë në kuadër të SHSKUK, e i cili është bartur në MSH respektivisht në AFSH dhe gjendja nuk është përmirësuar më furnizimin me barna. AFSH nuk e ka kompetencë të zhvillojë procedura tenderuese për furnizim me barna, AFSH është agjenci që ka përgjegjësi të blejë shërbime shëndetësore nga institucionet shëndetësore. Pyetje. A do të vazhdoni që të mbani këtë buxhet në MSH-AFSH apo do të riktheni te SHSKUK-ja. Projekti apo marrëveshja me Austrinë për koronarografin a ka përfunduar apo akoma vazhdojnë që pajisjet të qëndrojnë në Austri. Pasi që për këtë marrëveshja ka pasur diskutime të shumta dhe në bazë të marrëveshjes afati i instalimit të këtyre pajisjeve ka kaluar moti. Inspektorati shëndetësor duhet të fuqizohet dhe inspektimet që i bëjnë t'i bëjnë të njëjta si për institucionet publike edhe ato private, pra kushtet që i kërkon në një institucion privat t'i kërkojë edhe në institucionet publike. Edukimi i vazhdueshëm profesional, në Prizren edhe në disa qytetet të tjera duhet të organizohet edhe në gjuhët e tjera të komuniteteve. A do të filloni me zbatimin e ligjit për shërbimin emergjent pasi që ka një reformë në këtë shërbim edhe kërkon mbështetje politike edhe financiare. Urojmë që me të vërtetë sektori i shëndetësisë të jetë prioritet i kësaj qeverie. Ju faleminderit!

Enver Hoti: Faleminderit kryetare, përshëndetje për ministrin. Urime ministër edhe ne ju urojmë suksese në detyrën e re! Ju potencuat se do të filloni më reforme në sistemin shëndetësor thuajse nuk ka filluar asnjë reforme deri me tani. Ne të gjithë e dimë se gjendja në shëndetësi është jashtëzakonisht keq dhe qytetarët po i vuajnë pasojat. Kjo situatë është si rezultat i ndërhyrjeve politike që janë bërë në vazhdimësi për interesa të caktuar ndërhyrje që fatkeqësisht ka gjetur përkrahje nga disa menaxherë në sektorin e shëndetësisë. Në këtë rast urojmë që ju të mos jeni të ndikuar politikisht, por të punoni në të mirë të përmirësimit të këtij sistemi dhe të kemi shërbime më cilësore për gjithë qytetarët. Bashkëpunimi apo mbështetja jone s'do të mungojë për punë të mira në përmirësim të sistemit shëndetësor. Ju faleminderit!

Bekim Haxhiu: Uroj ministrin të ketë sukses në detyrën e re. Diskutimet tona të merren si rekomandime pasi sektori i shëndetësisë ka shumë probleme. Duhet të kesh objektiva të qarta se nga do ta orientosh shëndetësinë. Duhet ta analizoni mirë nevojën për ndryshim të pakos ligjore në shëndetësisë sepse ligji për sigurime shëndetësore i miratuar më herët nga Kuvendi i Kosovës do ndryshim dhe harmonizim me disa ligje të Ministrisë së Financave, sidomos te pjesa e tatimit të vlerës së shtuar. Gjithashtu duhet ndryshuar edhe Ligji për odat e profesionistëve shëndetësorë dhe duhet të bëhet bartja e plotë e kompetencave te odat. Deri tani ka qenë një qasje jo korrekte e Ministrisë së Shëndetësisë në bartjen e kompetencave te odat. Edhe planifikimi i specializimeve

duhet të bëhet nga organet kompetente sipas nevojave të tyre. Më intereson të di se ku ndodhet procesi i sigurimeve shëndetësore dhe kur do të fillojnë të zbatohen sigurimet shëndetësore?

Po ashtu kur do të bëhet funksionalizimi i SISH dhe i AFSH së, dhe a do të arrish ta depolitizosh AFSH- në? Edhe planifikimi i kuadrit duhet të bëhet sipas rregullave dhe standardeve sepse kemi klinika ku kemi më shumë mjekë sesa pacientë!

Bashkëpunimi i juaj me odat e profesionistëve shëndetësorë është i domosdoshëm.

Një nga prioritetet tuaja duhet të jetë ndalja e abuzimeve dhe nxjerrja para drejtësisë e atyre që janë përgjegjës, sidomos për rastin e gazit që ndodhi kohën e fundit dhe rastin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeveris së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive. Marrëveshja është votuar në Kuvend me vlerë 2.5 milionë euro dhe pajisjet nuk kanë ardhur ende, ndërsa Ministria e Shëndetësisë ndëshkohet 50 mijë euro në muaj për vonesat. Përgjegjësit për vonesa në përgatitjen e hapësirave dhe për keqpërdorimet me këtë marrëveshje duhet të dalin para drejtësisë.

Janë ngritur shqetësime edhe për cilësinë e insulinave dhe përgjegjësit për licencimin dhe shpërndarjen e këtij produkti i cili ka dëmtuar shëndetin e qytetarëve, duhet të merren në përgjegjësi. Bashkëpunimi jonë me ju nuk do të mungojë në zgjidhjen e problemeve që ekzistojnë në shëndetësi.

Besa Baftiu: Problemet në shëndetësi janë të shumta, ne do të diskutojmë dhe do të ballafaqohemi në vazhdimësi me këto probleme, por edhe do të bashkëpunojmë në gjetjen e zgjidhjeve. Do të ketë edhe kritika dhe sugjerime me qëllim të zgjidhjes së problemeve dhe besoj do t'i merrni parasysh. Në qeverisjen e kaluar, në program qeverisës kanë pasur emrin e një shëndetësie moderne, por në realitet ka ndodhur e kundërta, prandaj ne nuk ju besojmë shumë letrave, por besojmë nëse do të bëhet punë e mirë në këtë drejtim. Sa i përket marrëveshjes së Qeveris së Kosovës dhe Unicredit Bank, si komision në mandatin e kaluar kemi pasur shqetësimet tona, por fatkeqësisht zbatimi nuk ka shkuar si duhet, dhe që nga muaji shkurt paguhen gjatë prej 50 mijë euro në muaj, për vonesat.

Te sigurimet shëndetësore është shumë e rëndësishme funksionalizimi i SISH- it dhe për këtë edhe Kuvendi i Kosovës me iniciativë të GP-VV, ka miratuar një rezolutë që ka të bëjë me SISH- in, për të cilin janë dhënë miliona, por ende nuk është funksional. Ministrin rezoluta e obligon të raportoni në baza të rregullta mujore për funksionalizimin e SISH-it.

Uran Ismaili: Me vete kam bashkëpunëtorët të cilët do të më ndihmojnë në arritjen e realizimit të detyrave tona. Rina Limani, këshilltare, stomatologe me profesion, Njazi Gashi, gjithashtu këshilltar dhe Donika Bajrami, po ashtu këshilltare dhe stomatologe me profesion.

Do filloj me këshillën e z. Hoti që ta largoj politikën nga sistemi shëndetësor. Mendoj se i kam duart e zgjidhura nga politika, por shpresoj që edhe njerëzit e tjerë t'i kenë duart e zgjidhura nga politika.

E dëgjova edhe deputetin z. Avdyli i cili tha se po menaxhoj zjarre, e unë i them se po menaxhoj zjarret që i kanë krijuar ministri dhe kryeministri i kaluar. Kam gjetur një mal parregullsisht në shëndetësi, por nuk kam akuzuar askënd, jam përpjekur vetëm të shikoj se si mund të ecet përpara. Sa i përket sigurimeve shëndetësore, nuk thashë që sektori i shëndetësisë nuk ka nevojë për financa, por thashë se nuk është zgjidhja e vetme ideja që vetëm të financojmë, sepse ideja e financimit në një sistem të parregullsisht krijon dhe e rrit korrupsionin. Është një peizazh i madh i problemeve të sektorëve të ndryshëm në shëndetësi dhe nëse ne vetëm jemi parë, pa e rregulluar menaxhimin, atëherë vetëm po e ushqejmë korrupsionin. Unë kam për ta këputur korrupsionin dhe do të bashkëpunoj edhe me ju dhe do të diskutojmë për problemet në shëndetësi sa herë të ketë nevojë.

Sa i përket marrjes së buxhetit të sigurimeve shëndetësore dhe bartjes në një sektor tjetër kjo ka ndodh për shkak se Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur me funksionalizuar Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Kemi një vendim të ish- kryeministrit i cili e ka ndal fillimin e mbledhjes së premieeve.

Vizitën në spitale e kam bërë me qëllim që t'i informoj personelin shëndetësor dhe pacientët se unë jam pranë tyre dhe do t'i përkrahu. E pranoj sugjerimin që t'i vizitoj edhe ato vende që nuk i kam vizituar. Sa i përket sigurimeve shëndetësore është krijuar një situatë jo reale ku thuhet që sigurimet shëndetësore do të fillojnë, e realisht nuk shpjegohet te institucionet se si kanë me hyrë në këtë zinxhir, as nuk dihet se sa akte nënligjore kanë me u nxjerrë, as nuk dihet sa njerëz duhet të punojnë në sistemin e sigurimeve shëndetësore, e që nuk janë as të buxhetuar.

Unë më herët kam punuar në krijim të agjencive dhe e di që funksionalizimi i AFSH-së, me fjalime politike nuk do të bëhet. Ligjin nuk e kam futur në strategji legjislativë për ndryshim sepse dua që ta përgatis mirë dhe kur të vijë në Kuvend të jetë i përgatitur dhe analizuar mirë.

Që nga fillimi i punës sime, si ministër, i kam cekur tri gjëra dhe prapë do t'i them, transparenca, llogaridhënia dhe rritja e buxhetit. Këto që i kamë thënë do t'i realizoj, por janë edhe disa çështje të tjera që do të duhet t'i realizoj, si krijimi i kuadrove të reja, pastaj produktiviteti i mjekëve dhe shumë çështje të tjera.

Buxheti për shëndetësi do të rritet dhe këtu nuk ka dilemë. Sigurime shëndetësore qytetarët e Kosovës do t'i kenë jo vetëm në letër, por do të ndodhë me të vërtetë. Për këtë proces do të njoftohen të gjithë, edhe ju si deputetë, por edhe të gjithë qytetarët e tjerë, e jo siç ka ndodhur deri tani që vetëm ministri dhe një rreth i ngushtë i tij e dinin se çfarë po ndodh. Sa i përket Ligjit për emergjencë ju them se në preventivë do të investojmë pas analizimit të situatës dhe harmonizimit të ligjeve dhe akteve nënligjore.

Sa i përket fruthit ka pasur një sukses sistemi i vaksinimit, por tani ka pasur një situatë e cila ndoshta kërkon një vetëdijesim më të madh.

Fatmire Mulhaxha: Tema e vaksinimit është temë aktuale dhe situata mund të eskaloj, prandaj kërkoj që të ketë një mbështetje më të madhe për njësinë e vaksinimit dhe të investohet në preventivë.

Uran Ismaili, gjithsesi mendoj të investojmë në preventivë se rezultati kthyes është shumë i lartë. Sa i përket ndërtimit të Spitalit të Prishtinës kjo çështje ka ngecur si peng i politikës. Tani kemi një Projektligj për Prishtinën i cili nuk e precizon çart çështjen e spitalit, por unë mendoj se Spitali i Prishtinës do të bëhet.

Sa i përket bashkëpunimit me Shqipërinë do shikojmë mënyrat dhe format më të mira të bashkëpunimit.

Tenderimet e barnave, është problem shumë i madh, prandaj kam kërkuar ndihmë edhe nga donatorët, për ekspertizë.

Edhe inspektorati nuk ka pasur sukses sepse ka një numër shumë të vogël dhe kërkon përkrahje.

Sa i përket specialistëve synimi jonë është që të gjithë specialistët të punësohen dhe mos të ketë asnjë mjek pa punë.

Sa i përket marrëveshjes me Austrinë për koronarografi, kjo marrëveshje nuk është zbatuar dhe koronarografi ende nuk ka ardhur, besoj se shumë shpejt do ta gjejmë zgjidhjen. Me ardhjen e aparaturës së koronarografis lista e pritjes do të ulet.

Sa i përket fondit të barnave, ky fond ka lëvizur herë në SHSKUK e herë në AFSH, por nga informatat që kam asnjëherë më keq se këtë vit nuk ka qenë furnizimi me barna.

Për sigurime shëndetësore jam duke punuar çdo ditë dhe jam duke bashkëpunuar edhe me Bankën Botërore. Tentoj që në fund të vitit 2018 të pilotohet zbatimi i sigurimeve shëndetësore.

Zbatimi i Ligjit për sigurime shëndetësore e ndërron krejt sistemin shëndetësor, prandaj ka nevojë që fillimisht të pilotohet në një pjesë e pastaj të përfshihet i tërë sistemi shëndetësor.

Besa Baftiu: Përgjigjet që dhatë ministër ishin shumë të përgjithësuara, thatë se do të ketë sigurime shëndetësore, por kur do të ketë nuk e thatë, thatë se do të rritet buxheti, por sa do të rritet nuk e thatë, edhe koronarografi kur do të vendoset nuk e thatë.

Sa i përket punësimit të specialistëve edhe punësimet e fundit që janë bërë, janë bërë pa kriter apo sipas kriterit politik. Këtyre parregullsive duhet të ju jepet fund.

Flora Brovina: Sa i përket SISH, pilot- projekti në disa klinika ka pasur sukses, si në Klinikën Infektive, në Stomatologji, në një qendër në Prizren, prandaj ato duhet të merren si model dhe SISH të shtrihet në gjithë sistemin e informimit shëndetësor.

Enver Hoti: Disa gjëra të qëlluara, por me afate të pa limituara. Sa i përket sigurimeve shëndetësore, është një lajm shumë i keq që ato nuk do të fillojnë të zbatohen deri në fund të vitit 2018 dhe atë vetëm si pilot -projekt. Të gjithë gjatë fushatës kemi dhënë premtim se sigurimet shëndetësore do të fillojnë menjëherë, megjithatë shpresojmë që në fund të vitit 2018 do të fillojnë dhe do të kenë sukses.

Këtu dëgjuam shumë rrëfime, por kisha kërkuar që të mos diskutojmë për interesa të ngushta nga vendi ku punoni, por të jemi më korrekt. Sistemi shëndetësor kërkon që të ketë financim, transparencë dhe llogaridhënie dhe një korrektësi të këtij sistemi.

Besa Baftiu: Krejt diskutimet që po i bëjmë, po i bëjmë me qëllimin më të mirë që të ketë përmirësime në sistemin shëndetësor.

Haxhi Avdyli: Jemi deputetë dhe kemi obligim t'i shprehim shqetësimet tona dhe po të them se do të jesh i lavdëruar ministër nëse punon mirë, por edhe i kritikuar nëse nuk punon mirë. Pajtohem pjesërisht që po thua se financimi nuk është problemi kryesor, por prapë mendoj se financimi i dobët i sistemit shëndetësor është problemi kryesor. Edhe menaxhimi dhe fushat e tjera janë të rëndësishme, por prapë të gjitha lidhen te financimi. Sistemi shëndetësor i Kosovës është sistemi më i nën financiar shëndetësor në Evropë dhe, nëse nuk ke financim, nuk mund t'i realizosh reformat në shëndetësi. Nëse ti nuk lufton që të rritesh financimin e qëndrueshëm do të dështoj reforma, si ju ka dështuar ministrave paraprakë. Kërkoj që të jeni një luftëtar që fondi prej 17 milionë i ndarë për sigurime shëndetësore të mos merret për qëllime të tjera, por të ri destinohet për shëndetësi, sepse ka nevoja të shumta. Historia e sigurimeve shëndetësore është një histori e dështuar që ka filluar që nga viti 2004 dhe ende nuk po realizohet.

Fatmire Mulhaxha, ministri e ceku se ka pasur një angazhim të madh rreth aferës më gazin që ndodhi në QKUK, dhe shpresoj që shumë shpejt ministri do të dalë me një raport të detajuar para qytetarëve dhe të njoftoj për rastin. Duhet që jo vetëm furnizuesi, por të gjithë përgjegjësit të dalin para drejtësisë.

Uran Ismaili: Sa i përket sigurimeve shëndetësore, kemi një pritje të madhe të popullatës dhe është shumë vështirë të thuhet se nuk do të fillojnë menjëherë, por ju them se nuk ka logjistikë dhe nuk ka kushte të përmbushura për të filluar menjëherë. Sigurimet do të fillojnë në fund të vitit të ardhshëm. Një sistem aq i madh duhet të përgatitet mirë dhe duhet të testohet. Ju duhet ta shihni si proces menaxherial, e jo si proces politik. Duhet ta testojmë në fund të vitit 2018 a po kemi sukses dhe a i kemi parapa të gjitha rreziqet.

Unë i pranoj kritikën dhe reflektoj, por të më thuhet se po i vizitoj spitalet për popullzim këtë nuk e pranoj. Unë do jem mik dhe bashkëpunëtor i juaj dhe kurdo që mendoni se ka nevojë për kritikë mos u ndalni sepse jemi këtu për të avancuar më tutje sistemin shëndetësor.

Bekim Haxhiu: Me çështjen e marrëveshjes për modernizimin e kardiokirurgjisë duhet të merreni urgjentisht, sepse ato janë para të taksapaguesve, nga marrëveshja është pritur shumë dhe nuk është bërë asgjë, dhe tani po paguhen edhe ndëshkime.

Në pakon ligjore për vitin 2018 nuk kam parë të është përfshirë plotësisht ndryshimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore dhe disa ligjeve të tjera të nevojshme. Janë disa hapa ligjorë që duhet të përmbushen para se të fillojë pilotimi i sigurimeve shëndetësore. Në ligjin ekzistues të sigurimeve shëndetësore nuk është përfshirë kategoria e të vetëpunësuarëve dhe shumë çështje të tjera që duhet të ndryshohen.

A mendon që SISH do të implementohet me aktorët aktual të cilët kanë dështuar tani 8 vjet, sepse pa funksionalizim të SISH-it nuk ka sigurime shëndetësore.

Uran Ismaili: SISH-i është një sistem pa të cilin nuk mund të bëjmë politika të mirëfillta, prandaj SISH-e ka rëndësinë e vet. Kam biseduar me donatorin dhe jemi në pritje të rivlerësimit të kësaj situatës nga një ekspert i tyre. Posa ta kemi ekspertizën do ta ndaj me juve. SISH gjithsesi duhet të funksionalizohet, por do investime të mëdha.

Probleme ka shumë, edhe të mëdha edhe të vogla, prandaj duhet në mënyrë më të plotë të merrem me të gjitha problemet.

Sa i përket buxhetit nuk e di menjëherë sa buxhet nevojitet, do të shikoj sa ka projekte për të realizuar, pastaj të shohim sa ka nevojë për rritje të buxhetit.

Çështjen e problemit të gazit në QKUK, nuk kam tani asnjë mundësi të flas pasi prokuroria e ka marrë çështjen në dorë. Po të flas unë tani për këtë rast del se unë po e mbroj dikë apo po e fajësoj dikë. Posa ta kemi ndonjë raport apo informatë për këtë çështje do ta ndaj me ju dhe me qytetarët.

Besa Baftiu: Disa çështje janë urgjente e duhet të merreni shumë seriozisht, me to siç është çështja e koronarografisë, sepse përveç ndëshkimeve prej 50 mijë eurosh në muaj, ka edhe radhë të gjatë të pritjes së qytetarëve për të marrë shërbimet.

Si komision, e kemi marrë obligim, që ta monitorojmë zbatimin e marrëveshjes, dhe duhet të raportojmë për realizimin e marrëveshjes dhe për vendosjen e koronarografisë.

Uran Ismaili: Që nga fillimi i punës sime kam pasur disa çështje shumë urgjente, si furnizimi me barna nga lista esenciale ku kam marrë masa menjëherë që të kemi një furnizim sa më të mirë me barna. Edhe çështjen e zbatimit të marrëveshjes me Austrinë do ta marrë shumë seriozisht dhe në afat sa më të shkurtër do ju përcjelli një raport me shkrim.

Besa Baftiu: Në shëndetësi ka probleme të shumta dhe ne do ju ftojmë edhe në takime të tjera dhe të diskutojmë prapë. Si Komision do të mbështesim nëse do bëni punë të mira për shëndetësinë, por edhe do të jemi kritik, kur ka nevojë. Ju faleminderit për pjesëmarrje!

4. Shqyrtimi i draft- planit të punës së Komisionit për vitin 2017

Besa Baftiu: Kemi një draft të përgatitur i cili është bërë duke u bazuar në strategjinë legjislative. Janë të përfshira edhe vizitat në institucione të caktuara. A keni ndonjë propozim apo ndonjë çështje tjetër të plotësohet?

Bekim Haxhiu: Në strategji nuk janë të përfshira ligjet më të rëndësishme të fushës së shëndetësisë, por shpresojmë do të vijmë në vitin e ardhshëm.

Flora Brovina: Ndoshta duhet ta përfshijmë në planin e punës edhe rishikimin e buxhetit.

Kryetarja: Pas diskutimeve, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë:

Përfundim:

Me shumicë votash për, dhe me një abstenim, Komisioni miratoi Planin e punës së Komisionit për vitin 2017.

5. Të ndryshme

Për këtë pikë nuk pati ndonjë çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:
Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU